



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 lidhur me nenin 14, paragrafi 1, dhe 3, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019”, e konform nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 6 paragrafi 3 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Miratohet vendimi paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 17, (shtatëmbdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës si më poshtë;

- 1.1 Parcela **P-72116003-04491-0** me sipërfaqe të përgjithshme prej **S= 162579m²**, sipas certifikatës së pronës **Nr.388/2026**, datës 12.05.2026, zona kadastrale **Bllacë**, vendi i quajtura **“Galusha/Biraç”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.
- 1.2 Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen për dhënien në shfrytëzim **S=37297m²** për “Ndërtimin e parkut energjetik diellor me kapacitet të instaluar prej 2MW”.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër, Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019” dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI